



Prishtinë: 13.06.2018

Kodi i ZRRE-së: V\_993\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1781\_03\_18**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **15.03.2017**.

### në seancën e mbajtur më datë 13.06.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit D. T. nga Graçanica me shifër **DPR - 90056618** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1781\_03\_18** i datës 15.03.2018.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 17.04.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori D.T. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se gjatë zhvendosjes së njehsorit në shtyllë është bërë gabimi ku shpenzimet e 5 apo 6 shtëpive janë regjistruar në njehsorin e tij. Konsumatori në ankesë ka theksuar se ai nuk ka jetuar aty dhe se këtë e tregon edhe shpenzimi i energjisë elektrik në transaksione dhe se ka paguar pa matje/paushall. Konsumatori ka theksuar se ai është vendosur në shtëpinë e tij prej 01.10.2018 dhe se i ka kryer të gjitha faturat e vitit 20107 dhe për këtë borxh pret përgjigje nga ZRRE. Konsumatori ka theksuar se KEDS Graçanica e ka përpiluar një raport për këtë dhe e ka dërguar te përfaqësuesit e tyre në drejtori dhe se këtë dokument mundeni me marr në formë zyrtare.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të konsumatorit të theksuara në ankesë, por që nuk ka vërtetuar me asnjë element se konsumatori është i dëmtuar me ngarkesën e bërë nga Departamenti i Faturimit i KESCO.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të paditësit se gjatë zhvendosjes është bërë gabim në shpenzimin e energjisë elektrike ku shpenzimet e 5 apo 6 shtëpive janë regjistruar në njehsorin e tij, Bordi i ZRRE-së thekson se në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0161864 të datës 12.09.2015 përveç tjerash është theksuar se me projekt të KEDS-it bëhet zhvendosja e njehsorit në shtyllë me ormanin me dy njehsor, por që nuk është theksuar pohimi i konsumatorit se është bërë gabim në regjistrimin e shpenzimit të energjisë elektrike. Madje as në përgjigjen e KESCO-s dhënë konsumatorit me datë 20.05.2016 nuk është potencuar se është bërë gabim në regjistrimin e shpenzimit të energjisë elektrike e as madje nuk është theksuar se ekziston ndonjë dokument apo raport se te konsumatori në fjalë është bërë gabim në regjistrimin e shpenzimit të energjisë elektrike.

Bordi ka analizuar të gjitha konstatimet e theksuara nga shkalla e parë lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik nr.17675608 prej TL=46909 kWh dhe TU=64572 kWh të evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0161864 të datës 12.09.2015 dhe ka konstatuar se gjendja e shpenzimit të njehsorit elektrik në procesverbalin e lartcekur përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në programin e faturimit në CCP në periudhën 09/2015. Sipas procesverbalit të ndërrimit të njehsorit elektrik vërehet se njehsori elektrik nr.16067206 i montuar me datë 12.09.2015 është regjistruar pa shpenzim TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh, pra nuk ka pasur shpenzim të energjisë elektrike të regjistruar në njehsor.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar me kujdes edhe listat e leximit për periudhën 06/2015 deri më 12/2016 dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë lexime të rregullta mujore dhe se në asnjërin prej listave të leximit nuk është vërejtur se lexuesi i KEDS-it ka evidentuar se kemi të bëjmë me lexim apo me matje jo të rregullt, apo që kemi ndonjë gabim në lidhjen e njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e përgjithshëm të energjisë elektrike dhe ka konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike, por që konsumatori në fjalë që nga prej periudhës 11/2009 e deri më 08/2015 është faturuar vetëm me taksë dhe pa shpenzim të energjisë elektrike, ndërsa në muajin 09/2015 është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe se në këtë muaj me njehsorin e ri elektrik është faturuar shpenzimi prej 3,202 kWh në muaj, si dhe në muajin 10/2015 konsumatori është faturuar me shpenzim 842 kWh. Pas kësaj vlen të theksohet se konsumatori në muajin 11/2015 është faturuar me shpenzim prej 16 kWh, në muajin 12/2015 me shpenzim prej 86 kWh, ndërsa nga periudha 01/2016 e deri më 08/2017 është faturuar pothuajse pa shpenzim, dhe nga periudha 09/2017 e tutje është faturuar me shpenzim të ulët. Pra, nga rrjedha e energjisë elektrike aktive vërehet qartë se konsumatori shpenzim të lartë ka vetëm në periudhën 09/2015 dhe në periudhën 10/2015, ndërsa në periudhat para dhe pas kësaj periudhe pothuajse nuk ka fare shpenzim ose ka faturim shumë të ulët. Pra Bordi i ZRRE bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Energji ku thuhet se: **"1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim".**

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit D. T. dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.